

VENDIM
Nr. 247, datë 30.3.2016

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR E KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQES PYJORE PREJ 76.09 HA, NË NGASTRAT 84a, 85a, 85b, 86a,
87b, 88a, 89a DHE 94a, TË EKONOMISË PYJORE “KRASTË-KRUJË”, NË OBJEKTIN
“FUSHË-KRUJË”, TË QARKUT DURRËS, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA
“VICTORIA INVEST” SHPK PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË GURIT
GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike, prej 76.09 (shtatëdhjetë e gjashtë pikë zero nëntë) ha, në objektin e quajtur “Fushë-Krujë”, pjesë e ngastrave 84a, 85a, 85b, 86/a, 87b, 88a, 89a dhe 94a, të ekonomisë pyjore “Kraстë-Krujë”, që do të përdoret nga shoqëria “*Victoria Invest*” sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas lidhjes 1, me të dhënat për ngastrat pyjore, dhe hartës topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt minerar, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të sipërfaqes dhe të volumit të lëndës drusore paguhen nga shoqëria “*Victoria Invest*” sh.p.k. përpara lidhjes së marrëveshjes me Ministrinë e Mjedisit, në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “*Victoria Invest*” sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet që përdor, sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 5 (pesë) viteve të para, të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 228.26 (dyqind e njëzet e tetë pikë njëzet e gjashtë) ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “*Victoria Invest*” sh.p.k. të nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin dhe realizimin e projekteve teknike, sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.


6. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të bëjë çregjistrimin e sipërfaqes pyjore, të identifikuar sipas lidhjes 1 të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore/kullorë” dhe ta regjistrojë atë në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “*Victoria Invest*” sh.p.k. sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe shoqëria “*Victoria Invest*” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



**LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA
FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA "VICTORIA INVEST" sh.p.k. në qarkun e DURRËSIT**

QARKU DURRËS, rrethi Krujë

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Perdorimi territorit</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
DR 10 84a	Kraste-Kruje	84 a	trungishte	Ministria Mjedisit	3.9806
DR 10 85a	Kraste-Kruje	85 a	trungishte	Ministria Mjedisit	0.3201
DR 10 85b	Kraste-Kruje	85 b	trungishte	Ministria Mjedisit	3.4331
DR 10 86a	Kraste-Kruje	86 a	trungishte	Ministria Mjedisit	0.8758
DR 10 87b	Kraste-Kruje	87 b	trungishte	Ministria Mjedisit	2.4728
DR 10 88a	Kraste-Kruje	88 a	trungishte	Ministria Mjedisit	24.4537
DR 10 89a	Kraste-Kruje	89 a	trungishte	Ministria Mjedisit	21.5856
DR 10 94a	Kraste-Kruje	94 a	trungishte	Ministria Mjedisit	18.9643
GJITHSEJ					76.09